



## VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

Për tremujorin e tretë 2022

2

0

2

2

Tetor 2022

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

### ***Shënime të përgjithshme***

*Pyetëtori i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues synon të mbledhë opinionin e bankave tregtare lidhur me zhvillimet e tre muajve më të fundit në ofertën dhe kërkesën për kredi, si dhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues jep në mënyrë të përmbledhur perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi - ilustruar nëpërmjet standardeve, kushteve e termave të kreditimit dhe kredive të miratuara - si dhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset ashtu edhe për individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e nëntë bankave, të cilat zotërojnë peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.*

*Pyetëtori, në vija të përgjithshme, ndjek praktikën e ndjekur nga Banka Qendrore Evropiane, por është i përshtatur me specifikat e tregut tonë të kredisë për sektorin privat. Seritë e treguesve janë testuar për praninë e sezonalitetit dhe, aty ku ky efekt shfaqet, seritë janë korrektuar. Për më shumë detaje, Pyetësorin e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues, së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi, disa aspekte metodologjike, si dhe seritë e përdorura në analizë, i gjeni të publikuar në adresën:*

*[https://www.bankofalbania.org/Politika\\_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi\\_i\\_aktivitetit\\_kreditues/](https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/)*

## **PËRMBLEDHJE**

*Politikat e kreditimit në tremujorin e tretë reflektuan prudencën e shtuar të bankave kundrejt kërkesave për kredi nga të gjithë agjentët ekonomikë. Bankat tregtare shtrënguan standardet e kreditimit për kreditë e reja akorduar bizneseve dhe individëve, si në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë nga bizneset dhe nga individët, ashtu edhe në prizmin e madhësisë së biznesit. Së bashku me standardet, bankat shtrënguan edhe kushtet e termat e kreditimit, si për bizneset ashtu edhe për individët. Politikat e kujdesshme të kreditimit u reflektuan edhe në një shkallë më të ulët kredish të miratuara për të gjithë agjentët ekonomikë në tremujorin e tretë. Përqasja më konservatore e bankave në trajtimin e kërkesave për kredi u nxit nga perceptimet lidhur me dobësimin e kërkesës së brendshme dhe pasiguritë e shtuara në ekonomi, të cilat shtojnë vigjilencën e bankave lidhur me vlerësimet për aftësinë paguese të kredimarrësve.*

*Kërkesa për kredi u shfaq e lartë në të gjitha hallkat e madhësisë së biznesit, si në financimin e investimeve ashtu edhe të inventarëve e kapitalit qarkullues. Një nga faktorët kryesorë që nxitin kërkesën për kredi ishin kostot e shtuara, si pasojë e rritjes së presioneve inflacioniste. Nga ana tjetër, kostot e shtuara të energjisë kanë nxitur bizneset të kërkojnë financime të reja për të realizuar investime në burime të energjisë së rinovueshme. Individët shfaqën një kërkesë më të ulët për kredi, për herë të parë pas gjashtë tremujorësh rritjeje. Rënia e kërkesës për kredi nga individët, në gjykimin e bankave tregtare, ndër të tjera, pati si faktor ambientin e normave të rritura të interesit, nxitur nga politikat monetare të ndjekura nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore Evropiane.*

*Në tremujorin e fundit, bankat presin të vijojnë me përqasjen e kujdesshme ndaj kreditimit. Përballë kushteve të shtrënguara të ofertës, edhe kërkesa për kredi pritet të jetë më e ulët në tremujorin e fundit të vitit.*


# KUSHTET E OFERTËS DHE KËRKESA PËR KREDI

## 1. KREDIA PËR BIZNESE

### 1.1. Standardet e kreditimit

**Standardet e kreditimit për bizneset vijuan shtrëngimin** në tremujorin e tretë të vitit 2022. Shtrëngimi i standardeve u manifestua si në kreditë akorduar biznesit të vogël e të mesëm, ashtu edhe në ato për biznesin e madh. Standardet e kreditimit u shtrënguan, si në kreditë për financimin e investimeve, ashtu edhe në ato për mbulimin e nevojave për likuiditet.

Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm<sup>1</sup>




<sup>1</sup>: Logariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët që sollën shtrëngimin e standardeve të kreditimit për bizneset buronin kryesisht nga perceptimi i rrezikut nga ana e bankave lidhur me: situatën ekonomike në vend dhe perspektivën për të; aftësinë paguese të kredimarrësit; si edhe me kolateralin e kërkuar. Në të njëjtën kohë, edhe toleranca më e ulët e bankave kundrejt rrezikut ndikoi në shtrëngimin e standardeve për bizneset. Në kahun lehtësues të standardeve u raportua trysnia e shtuar nga konkurrenca në sistemin bankar.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve<sup>2</sup>



<sup>2</sup>: Logariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e fundit të vitit 2022, bankat presin që ecuria e standardeve të kreditimit të mos ndryshojë nga ajo e tremujorit të tretë (*Grafik 1*). Kështu, standardet e kreditimit priten të mbeten të shtrënguara, në të dyja kategoritë e madhësisë së biznesit. Në terma të qëllimit të përdorimit, standardet priten të vijojnë shtrëngimin në kreditë për financimin e investimeve dhe të lehtësohen në ato për mbulimin e nevojave për likuiditet.

## 1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

**Kushtet dhe termat e përgjithshëm mbi kreditë e reja disbursuar bizneseve vijuan shtrëngimin në tremujorin e tretë.** Ky shtrëngim u arrit si nga elementet çmim, ashtu edhe nga ato joçmim. Kështu, bankat raportuan marzhe më të larta, si në kreditë normale ashtu edhe në ato me rrezik; reduktuan madhësinë e kredisë akorduar bizneseve; rritën komisionet jointeres; shkurtuan maturitetin maksimal të kredisë; si edhe shtuan numrin e kushtëzimeve në marrëveshjet e kredisë, të nënshkruara mes bankave dhe bizneseve.


Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për bizneset<sup>3</sup>



<sup>3</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuara, ndërsa ato negative të shtrënguara. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtrëngimi i kushteve dhe termave të kreditimit për bizneset në tremujorin e tretë u ndikua nga: perceptimi i bankave për rrezik të shtuar; toleranca më e ulët e tyre kundrejt këtij rreziku; si edhe kostot e shtuara të fondeve.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve<sup>4</sup>




<sup>4</sup>: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 1.3. Shkalla e miratimit të kredive

**Shkalla e miratimit të kredive për bizneset u raportua më e ulët** në tremujorin e tretë. Faktorët pas pritjes së shkallës së refuzimeve (rënies së shkallës së miratimit) për kredi në këtë tremujor ishin: perceptimi i bankave për rrezik të shtuar lidhur me perspektivën e sektorit ku operojnë bizneset; me gjendjen financiare të bizneseve; me aftësinë paguese të kredimarrësit; si edhe faktorët e lidhur me kuadrin e politikave të kreditimit të bankave. Në kahun rënës të shkallës së refuzimeve të kredive u raportuan historiku i marrëdhënieve të biznesit me bankën dhe historiku nga regjistri i kreditës.

Grafik 5. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të bizneseve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave<sup>5</sup>




<sup>5</sup>: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 1.4. Kërkesa për kredi

**Kërkesa për kredi e bizneseve vijoi të jetë e lartë** edhe në tremujorin e tretë. Kërkesa e shtuar për kredi ishte e evidente në të gjitha segmentet e madhësisë së biznesit, si edhe në të gjitha llojet e përdorimit të kreditës.


Grafik 6. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset<sup>6</sup>



<sup>6</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e shtuar për kredi nga bizneset, sipas gjykimit të bankave, u ndikua kryesisht nga nevojat më të larta për financimin e inventarëve dhe kapitalit qarkullues, për financimin e investimeve, si dhe për rifinancimin e borxheve ekzistuese. Nga ana tjetër, kreditë nga bankat e tjera, përdorimi i burimeve të brendshme të financimit, situata ekonomike në vend e perspektiva për të, niveli i përgjithshëm i normave të interesit, si edhe besimi i biznesit, janë raportuar si faktorë që kanë dekurajuar kërkesën për kredi të bizneseve në tremujorin e tretë.

Grafik 7. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi nga bizneset<sup>7</sup>



<sup>7</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënieën e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Kërkesa për kredi e bizneseve pritet të bjerë në tremujorin e fundit të vitit, kryesisht në sajë të tkurrjes së pritit të kredisë për qëllime investimi ([Grafik 6](#)). Në terma të madhësisë së biznesit, kredia pritet të vijojë rritjen në segmentin e biznesit të madh, e të ulet në atë të biznesit të vogël e të mesëm.

## 2. KREDIA PËR INDIVIDË

### 2.1. Standardet e kreditimit

**Standardet e kreditimit për individët u shtrënguan** në tremujorin e tretë të vitit 2022. Shtrëngimi i standardeve u vërejt në të dyja kategoritë e qëllimit të përdorimit të kredisë, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu edhe në atë konsumatore.


Grafik 8. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm<sup>8</sup>



<sup>8</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtrëngimi i standardeve të kreditimit për individët ishte pasojë e perceptimit të rrezikut nga bankat lidhur me: situatën makroekonomike në vend e perspektivën për të; zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave; aftësinë paguese të kredimarrësit; si edhe me kolateralin e kërkuar. Po ashtu, faktor tjetër që ndikoi në shtrëngimin e standardeve të kreditimit ishte edhe toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut.

Grafik 9. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve<sup>9</sup>



<sup>9</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.




Standardet e kreditimit për individët priten të shtrëngohen më tej në tremujorin e fundit, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu dhe në ato konsumatore (*Grafik 8*).

## 2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

**Kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë akorduar individëve u shtrënguan** në tremujorin e tretë. Shtrëngimi i kushteve dhe termave të kreditimit u arrit në sajë të: marzheve më të larta mbi kreditë, si mbi ato normale, ashtu edhe mbi ato me rrezik; reduktimit të madhësisë së kredisë; si edhe kërkesave të shtuara për kolateral, vetëm në kreditë për blerjen e banesave.

Grafik 10. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për individët<sup>10</sup>




<sup>10</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Perceptimi i bankave mbi rrezikun dhe toleranca më e ulët e tyre ndaj këtij rreziku sollën shtrëngimin e kushteve e termave të kreditimit për individët në tremujorin e tretë. Konkurrenca në sistemin bankar u raportua si faktor me ndikim lehtësues në kushtet e termat e kreditimit për individët.

Grafik 11. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve<sup>11</sup>




<sup>11</sup>: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 2.3. Shkalla e miratimit të kredive

**Shkalla e miratimit të kredive për individët u reduktua në tremujorin e tretë.** Raporti më i lartë i kredive të refuzuara në këtë tremujor u nxit nga faktorët e lidhur me aftësinë paguese të kredimarrësit, si të ardhurat e disponueshme dhe historiku i punësimit në tregun e punës; dhe nga faktorët e lidhur me kuadrin administrativ të politikave të kreditimit nga ana e bankave, si pozicioni gjeografik i pronës dhe mungesa e dokumentacionit të paraqitur nga ana e individëve.

Grafik 12. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të individëve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave<sup>12</sup>




<sup>12</sup>: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 2.4. Kërkesa për kredi

**Kërkesa e individëve për kredi u perceptua me rënie në tremujorin e tretë,** si për kreditë për blerjen e banesave, ashtu edhe për ato konsumatore. Në tremujorin e fundit të vitit 2022, bankat presin që kërkesa për kredi të jetë sërish në rënie, si në blerjen e banesave, ashtu edhe në financimin e konsumit.


Grafik 13. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët<sup>13</sup>



<sup>13</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndikimin kryesor në rënien e kërkesës për kredi, sipas gjykimit të bankave, e kanë dhënë: niveli i përgjithshëm i normave të interesit; zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave; si edhe besimi konsumator.

Grafik 14. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët<sup>14</sup>



<sup>14</sup>: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.